



REPUBLIKA E SHQIPERISË
KËSHILLI BASHKIAK
GRAMSH

Nr. 1988 prot.

Gramsh, më 10/05/2023

VENDIM

Nr. 31 , datë 10.05.2023

PËR

ANULLIM të Vendimit nr.18 datë 28.02.2023 “Për dhënien e dakortësisë për vijimin e procedurave të heqjes nga fondi pyjor e kullosor publik për ndërtimin dhe operimin të HEC-ve “KUKUR 3” dhe “KUKUR 4” nga Shoqëria “KUKUR HIDRO ENERGY” shpk.

Këshilli Bashkiak në mbledhjen jashë radhe thirrur duke u mbështetur në ligjin 139/2015 neni 53 pika 3, nenit 57 të Rregullores së Funkionimit të Këshillit Bashkiak, datë 10.05.2023 pasi mori në shqyrtim, Peticion-Ankesën (nr.Regj 1648 date 05.05.2023) dhe dokumentacionin e paraqitur nga banorët e fshatrave Gribë, Kalaj, mbështetur në Ligjin 139/2015 datë 17.12.2015 “Për vetqeversijen vendore” i ndryshuar, neni 113 ,116(1) Ligji nr.44/2015 Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë dhe Rregulloren e Funkionimit të Këshillit Bashkiak neni 104,

VENDOSI:

1-Anullimin e Vendimit nr.18 datë 28.02.2023 “Për dhënien e dakortësisë për vijimin e procedurave të heqjes nga fondi pyjor e kullosor publik për ndërtimin dhe operimin të HEC-ve “KUKUR 3” dhe “KUKUR 4” nga Shoqëria “KUKUR HIDRO ENERGY” shpk.

2-Për ndjekjen dhe zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari i Bashkisë, Drejtoria e Shërbimit Pyjor, Mbrojtjes së Konsumatorit si strukturë përgjegjëse për pyjet dhe kullotat pranë Bashkisë Gramsh.

Ky vendim hynë në fuqi pas konfirmimit nga Prefekti i Qarkut Elbasan.

Sekretari i Këshillit Bashkiak
Xhulia GJINI

Konceptoi: Xh Gjini
Pranoi: G Lena
Miratoi: G Lena
Dosja nr.:
Afati i rivajtjes: RIK

Kryetari i Këshillit Bashkiak
Greta LENA

